



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Nr.04-111/01-18842/2018

Datë, 14.06.2018

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës shpallë:

KONKURS

Për Regjistrimin e Nxënësve në Klasën e Dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale për vitin shkollor 2018/2019

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2018/19, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim
Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:
Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
Ekstrakti i lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaz dhe shkollë profesionale për vitin shkollor 2018/2019, bëhet më datën 18,19, 20 dhe 21 qershor 2018 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 26.06.2018. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 27.06.2018. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka"- KAÇANIK

Nr.	DREJTIMI	PROFILI	Nr. i paraleleve	Nr.inxënësve
1.	ELEKTROTEKNIK Ë	- Teknik i telekomunikacionit - Teknik i informatikës - Instalues elektrik	1 paralele 1 paralele 1 paralele	32 nxënës 32 nxënës 24 nxënës
2.	EKONOMI	- Banka dhe sigurime - Asistent i marketingut	1 paralele 1 paralele	32 nxënës 32 nxënës
3	KOMUNIKACION	- Transport rrugor	1 paralele	32 nxënës
4.	MAKINERI	- Instalues i ngrohjes qendrore - Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit - Saldator - Automekanik -Mekatronik	1 paralele 1 paralele 1 paralele 1 paralele 1 paralele	24 nxënës 24 nxënës 24 nxënës 24 nxënës 32 nxënës
5.	JURIDIK	- Asistent juridik	1 paralele	32 nxënës
Gjithsej			12	344

Gjimnazi “Skënderbeu” - KAÇANIK

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr.i nxënësve
1.	Shkenca Natyrore	4	128
2.	Shkenca Shoqërore- Gjuhësore	5	160
Gjithsej		9	288

Drejtori i DAK
z. Zahir Doda

